



Datë: 30.09.2025
Numër Protokolli: 6466/2025

A.nr.1520/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1520/2025 të datës 01.08.2025 të parashtruar nga ankuesi G.H nga Vitia, kundër Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.1520/2025, e datës 01.08.2025 e parashtruar nga ankuesi G.H, ashtu që **aprovohet** pretendimi ankimor i ankuesit se procedura e rekrutimit për pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Ferizaj është përcjellë me shkelje materiale, ndërsa **refuzohet** pretendimi ankimor i ankuesit se procedura e rekrutimit për pozitën “*Referent*” në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën Themelore në Gjiilan është përcjellë me shkelje ligjore.

II. Ndryshohet Formulari i vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë për pozitën “*Referent*” në Gjykatën Themelore në Ferizaj, i datës 02.07.2025, ashtu që largohet nga lista kandidati i suksesshëm D.H.

III. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij, duke ndërmarr të gjitha veprimet që të vazhdojë me procesin e verifikimit para emërimit sipas Formularit të ndryshuar të datës 02.07.2025, si në pikën **II** të dispozitivit.

IV. Mbetet në fuqi Formulari i vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë për pozitën “*Referent*” në Gjykatën Themelore në Prishtinë, të datës 02.07.2025 dhe Formulari i vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë për pozitën “*Referent*” në Gjykatën Themelore në Gjiilan, i datës 02.07.2025.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me pikën III të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Kandidati në procedurë, G.H(në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi) me datë 30.07.2025 përmes poste ka parashtruar ankesë e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është pranuar me datë 01.08.2025 dhe është regjistruar me numër protokolli 5172/2025 nën shenjën A.nr.1520/2025, kundër procedurës së rekrutimit për pozitën “Referent” në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Ferizaj dhe Gjilan, të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 05.08.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 26.08.2025 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës, ndërsa për kërkesës për prova shtesë kjo e fundit ka ofruara prova dhe sqarime shtesë me datë 22.09.2025.

Kryetari i Këshillit, me datë 15.09.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:5178/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjën A.nr.1520/2025 të datës 01.08.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 5172/2025 të datës 01.08.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Zarf postar R8274071; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.08.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 26.08.2025; Formularët e vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë për Gjykatën Themelore në Prishtinë; Formularët e vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë për Gjykatën Themelore në Ferizaj; Formularët e vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë për Gjykatën Themelore në Gjilan; Vendimin e datës 13.06.2025 të Drejtorit i Përgjithshëm i Sekretarit të SKGJ; Konkursin e datës 29.04.2025; Testet me shkrim; Aplikacionin e ankuesit të datës 28.05.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Diplomën e datës 09.07.2008; Diplomën e datës 25.05.2018; Diplomën e datës 06.06.2014; Vërtetimin e datës 04.06.2009; Vërtetimin e datës 31.05.2010; Certifikatë e datës 11.12.2015; Aplikacionin e datës 26.05.2025 e kandidatit D.H me dokumentacionin e bashkangjitur; Diplomën e datës 24.09.2018; Pasqyra e llogarisë së trustit; Letër rekomandimin e datës 23.09.2019 lëshuar nga GSJP; Aplikacionin e kandidatit F.S të datës 23.05.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Vërtetimin e datës 06.05.2025; Diplomën e datës 21.03.2023; Kontratë e datës 29.06.2023; Aplikacionin e kandidates A.O të datës 19.05.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Diplomën e datës 26.06.2019; Certifikatë e datës 28.02.2020; Vendimin e datës 17.07.2023; Aplikacionin e ankuesit të datës 28.05.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Diplomën e datës 15.08.2008; Diplomën e datës 06.06.2014; Diplomën e datës

25.05.2018; Vërtetimin e datës 31.05.2010 lëshuar nga Prokuroria Publike Komunale; Vërtetimin e datës 08.12.2011.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës nga palët në këtë procedurë administrative, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është ***pjesërisht e bazuar***, sepse:

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, me datë 29.04.2025 ka shpallë konkursin e pranimit (i jashtëm) për pozitën “*Referent*”, 3 vende të lira, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Ferizaj dhe Gjilan, ndërsa bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht aplikacionit të ankuesit të datës 28.08.2025 konstatohet fakti se i njëjti ka aplikuar në tri pozitat e lira, si dhe e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe në të njëjtën kohë iu është nënshtruar procedurave të tjera të rekrutimit.

Tutje, sipas Formularët të vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë për Gjykatën Themelore në Prishtinë, të datës 02.07.2025, ankuesi iu ka nënshtruar testimit me shkrim dhe ka marr 50.8 pikë, ndërsa në intervistën me gojë ka marrë 23 pikë, ashtu që është renditur si kandidat i suksesshëm, i pesti (5) me radhë me gjithsejtë 73.8 pikë, kurse kandidati i renditur i pari (1) me më së shumti pikë rezulton të jetë kandidatja A.O me gjithsejtë 81.1 pikë, prej të cilave 56.6 pikë në testin me shkrim, ndërsa 24.5 pikë në intervistën me gojë.

Sipas Formularit të vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë për Gjykatën Themelore në Ferizaj të datës 02.07.2025 ankuesi iu ka nënshtruar testimit me shkrim dhe ka marr 50.8 pikë, ndërsa në intervistën me gojë ka marrë 23 pikë, ashtu që është renditur si kandidat i suksesshëm, i dyti (2) me radhë me gjithsejtë 73.8 pikë, kurse kandidati i renditur i pari (1) me më së shumti pikë rezulton të jetë kandidati D.H me gjithsejtë 76.5 pikë, prej të cilave 58.8 pikë në testin me shkrim, ndërsa 25.7 pikë në intervistën me gojë.

Sipas Formularët e vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë për Gjykatën Themelore në Gjilan, të datës 02.07.2025 ankuesi iu ka nënshtruar testimit me shkrim dhe ka marr 50.8 pikë, ndërsa në intervistën me gojë ka marrë 23 pikë, ashtu që është renditur si kandidat i suksesshëm i dyti (2) me radhë me gjithsejtë 73.8 pikë, kurse kandidati i renditur i pari (1) me më së shumti pikë rezulton të jetë kandidati F.S me gjithsejtë 78.3 pikë, prej të cilave 54.2 pikë në testin me shkrim, ndërsa 24.1 pikë në intervistën me gojë.

Ankuesi, i pakënaqur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit nga SKGJK, respektivisht njoftimit për kandidatët e suksesshëm, sipas udhëzimit në mjete juridike përmes aktit të kontestuar, me datë 01.08.2025 ka parashtruar ankesë në Këshill me pretendimin ankimor se Komisioni i Pranimit nuk ka vepruar drejtë pasi që ka shkelur nenin 12 të Ligjit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar,

ngase kandidatët nuk i kanë plotësuar kushtet më shumë sesa unë, me kërkesën që Këshilli ta anuloi konkursin në fjalë.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit dhe rrjedhimisht vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse, Kolegji i Këshillit, fillimisht ju referua Konkursit/Rezervuar për persona me aftësi të kufizuara, me numër 03/694 të shpallur me datën 29.04.2025 për pozitën “Referent”, tre (3) pozita, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe në Gjykatën Themelore në Gjiilan, e për rrjedhojë konstatoi se kriteret e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

- **Arsimimi i kërkuar** Diplomë Universitare të vlefshme në Kosovë: Fakulteti Juridik;
- **Përvoja e punës** Së paku një (1) vit përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Ndërsa, në cilësi të dokumentacioneve të nevojshme që është dashur të sigurohen për kandidatët në procedurë me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse, sipas konkursit të datës 29.04.2025, ndër tjerash kanë qenë: “Dëshmia nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale/Handikos që bënë pjesë në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara; Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen në atë pozitën. Dëshmisë së punësimit jashtë institucioneve publike duhet mbështetur së paku me njërën nga dëshmitë si në vijim: Pasqyra e Llogarisë në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale, si dhe Kopjet e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuara nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës,.....”

Kolegji i Këshillit, në mbështetje të dispozitave nga neni 2 paragrafi 3 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: “**2. Fusha e zbatimit**, 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë”, andaj mori për bazë aktet veçanta të legjislacionit sekondar të nxjerrë nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, respektivisht dispozitat e aplikuara të nenit 2 të Rregullores Nr. 02/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, ku përcaktohet se: “Kjo rregullore përcakton kategoritë dhe klasat e nëpunësve civil të administratës në sistemin gjyqësor, përfshirë emërtesat e pozitave për çdo klasë, grupin, koeficientin, përshkrimin përgjithshëm për secilën kategori dhe klasë, procedurën dhe metodologjinë e klasifikimit pozitave të punës”, ndërsa me nenin 26, paragrafi 6, nën paragrafi 6.14 të së njëjtës rregullore, është përcaktuara se pozita Referent, hynë në kuadër të kategorisë Profesional 1.

Po ashtu, me nenin 26 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 02/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, janë përcaktuar edhe çështjet e kërkesave formale, ku përcaktohet se: “Kërkesat e përgjithshme formale: 5.1. arsimimi i kërkuar: diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për fushën e TIK; 29/36 5.2. kërkesat specifike: certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të

nevojshme për pozitën e kësaj klase; 5.3. përvoja e punës e kërkuar: së paku një (1) vit përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës ”, ndërsa lidhur me përshkrimin e detyrave të punës, Kolegji i Këshillit ka pranuar përshkrimin e detyrave dhe kritereve të aprovuara për pozitën në fjalë, e që përputhen me ato të shpallura në konkursin e datës 29.04.2025 dhe paragrafin 5, neni 26 i Rregullores Nr. 02/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, dhe për rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstatoi se konkursi i datës 29.04.2025 për pozitën “Referent” është shpallur në pajtueshmëri me dispozitat e rregullores në fjalë për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Thënë si më lartë, dhe me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat nga neni 1 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimin, Emërimin dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor ku përcaktohet se: *“1. Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i kritereve, rregullave, themelimi i komisioneve, procedurave për rekrutim, vlerësimin, pranimin, emërimin dhe vlerësimin e punës provuese për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi. i 2. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga të gjitha palët e përfshira gjatë procedurës së rekrutimit, themelimit të komisioneve, vlerësimit, pranimin, emërimin dhe vlerësimit të punës provuese për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor. 3. Përjashtimisht paragrafit 2 të këtij neni, dispozitat e kësaj rregullore nuk zbatohen për pozitën: Drejtor i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit, Drejtor i Njësisë për Inspektim Gjyqësor, Drejtor Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, administratorët dhe zëvendës administratorët e gjykatave si dhe bashkëpunëtorët profesional ” dhe konstatoi se dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për pozitën “Referent” duke përfshirë edhe çështjen e plotësimit të kritereve përcaktuara si në konkursin përkatës.*

Andaj në referencë të konstatimit të dhënë si më lartë, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 16 paragrafi 1 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimin, Emërimin dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, kur përcaktohet se: *“1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit”, dhe pas analizimit të dosjeve të kandidatëve të suksesshëm për pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe në Gjykatën Themelore në Gjiçan, konstatoi si në vijim, se:*

Kandidati i suksesshëm D.H sipas Formularit të vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, të datës 02.07.2025 për pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Ferizaj, sipas aplikacionit të datës 26.05.2025 me dokumentet e bashkangjitura posedon: Diplomën e datës 24.09.2018 përmes së cilës dëshmohej fakti se i njëjti me datë 20.06.2018 ka mbaruar studimet themelore në Kolegjin AAB-Programi Juridik, dhe po ashtu posedon Vërtetimin e datës 06.01.2023 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve që dëshmon gjendjen shëndetësore, kurse lidhur me përvojën e punës i njëjti posedon Letër rekomandimin e datës 23.09.2019 të lëshuar nga GSJP, përmes të cilit dëshmohej se i njëjti ka qenë i angazhuar me punë praktike në këtë organizatë nga data 18.03.2019 e deri më 17.09.2019 (6 muaj), periudhë kjo e mbështetur edhe me pasqyrën e llogarisë së trustit, pasqyrë kjo e cila dëshmon edhe pagesa edhe nga institucione të tjera punëdhënëse, mirëpo kandidati në fjalë nuk ka

bashkangjitur dëshmitë përkatëse të punësimit (vërtetim apo kontratë) sikurse është përcaktuar me konkursin e datës 29.04.2025.

Nisur nga kjo rrethanë, Kolegji i Këshillit përmes, përfaqësuesit të autorizuar në këtë lëndë, me datë 15.09.2025 i është drejtuar njësisë së Burimeve Njerëzore në SKGJK, ndër tjerash me kërkesën si në vijim, **citoj**: “Te siguroheni nëse janë dërguar te kompletuara dosjet për kandidatet e suksesshëm (*Dëshmi për kualifikimin, përvojën e punës dhe dëshmitë që përcaktojnë aftësitë sipas natyrës së hapjes së konkursit*) për pozitën “Referent” sipas konkurseve në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe në Gjykatën Themelore në Gjiçan”, ndërsa njësia përkatëse me datë 26.09.2025, ka ofruar sërish aplikacionin e kandidatit D.H me të dhënat dhe dokumentet e bashkangjitura, mirëpo gjendja faktike mbetet e njëjtë, pra kandidati në fjalë të paktën me rastin e aplikimit nuk ka mundur ta mbështes me prova (vërtetim apo kontratë pune) kriterin e përvojës së punës, ndërsa Kolegji i Këshillit thekson faktin se, vetëm pasqyra e trustit nuk mund të merret si e mirëqenë pasi që kjo shkresë është vetëm si provë shoqëruese apo shtesë, ndërsa dëshmi bazë duhet të jetë vërtetimi apo kontrata e punës përmes së cilës pasqyrohet saktë fakti që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen në atë pozitë.

Kolegji i Këshillit po ashtu, analizoi aplikacionin e ankuesit të datës 28.05.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur dhe konstatoi se i njëjti posedon Diplomën e datës 15.08.2008 përmes së cilës dëshmohet fakti se i njëjti me datë 16.02.2008 ka mbaruar studimet themelore në Kolegjin FAMA-Fakulteti Juridik, dhe po ashtu posedon Vërtetimin Nr. 616/2011 e datës 08.12.2011 të lëshuar nga Handikos që dëshmon gjendjen shëndetësore, kurse lidhur me përvojën e punës i njëjti posedon Certifikatën e datës 11.12.2015 të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përmes të cilit dëshmohet se i njëjti ka kryer punë praktike gjyqësore në kohëzgjatje prej një (1) viti, dhe atë nga data 24.11.2014 e deri me datë 23.11.2015 në Gjykatën Themelore në Gjiçan-Dega Viti, nga rrjedh se i njëjti i ka plotësuar kushtet e veçanta dhe kriteret e përgjithshme formale të përcaktuara si në konkursin e datës 29.04.2025.

Andaj nisur nga kjo rrethanë dhe nga konstatimi i dhënë si më lartë, Kolegji i Këshillit konstatoi se kandidati i suksesshëm, i cili rezulton të ketë më shumë pikë se kandidatët e tjerë për pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Ferizaj, nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës së kërkuar sipas konkursit, të paktën sipas provave të ofruara në këtë procedurë administrative nuk mund të dëshmohet e kundërta e saj, nga rrjedh se organi i punësimit me rastin e përfshirjes së kandidatit D.H në listën e ngushtë apo kalimin e fazës së verifikimit paraprak, kanë vepruar në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 1 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, dhe për rrjedhojë pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar, ndërsa në mbështetje të dispozitave të aplikuara nga neni 132 paragrafi 4 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “4. Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulojë apo ndryshojë, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala”, Kolegji i Këshillit vendosi që të ndryshoi Formularin të vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, të datës 02.07.2025 për pozitën “Referent” në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ashtu që kandidati D.H largohet nga lista e kandidatëve të suksesshëm, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore e SKGJK obligohet që në këto rrethana të veproi në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara

nga neni 26 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, pasi që ankuesi sipas formularët përkatës mbetet kandidat i suksesshëm, respektivisht i njëjti pas ndryshimit të formularët përkatës të rezultateve përfundimtare, mbetet kandidatë i suksesshëm, dhe i pari me radhë me gjithsejtë 73.8 pikë.

Ndërsa, kandidatja e suksesshme A.O sipas Formularit të vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, të datës 02.07.2025 për pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Prishtinë, sipas aplikacionit të datës 19.05.2025 me dokumentet e bashkangjitura posedon: Diplomën e datës 26.06.2019 përmes së cilës dëshmohet fakti se e njëjta me datë 19.11.2018 ka mbaruar studimet themelore- Fakulteti Juridik në Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti”, dhe po ashtu posedon Vendimin e datës 17.07.2023 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve që dëshmon gjendjen shëndetësore, kurse lidhur me përvojën e punës e njëjta posedon Certifikatën e datës 28.08.2020 të lëshuar nga Gjykatat Themelore në Prizren, përmes të cilës dëshmohet se e njëjta ka kryer praktikën gjyqësore në kohëzgjatje (1 viti) nga data 01.03.2019 e deri më 28.02.2020, nga rrjedh se e njëjta i ka plotësuar kushtet e veçanta dhe kriteret e përgjithshme formale të përcaktuara si në konkursin e datës 29.04.2025, ashtu që konkursi i datës 29.04.2025 për pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Prishtinë, procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtueshmëri me parimet e përgjithshme të pranimit sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, prandaj lidhur me këtë rast pretendimi ankimor i ankuesit refuzohet ndërsa mbetet në fuqi Formulari i vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, të datës 02.07.2025 për pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Prishtinë, sikurse në dispozitiv e këtij vendimi.

Ndërsa, kandidati i suksesshëm F.S sipas Formularit të vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, të datës 02.07.2025 për pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Gjilan, sipas aplikacionit të datës 23.05.2025 me dokumentet e bashkangjitura posedon: Diplomën e datës 21.03.2023 përmes së cilës dëshmohet fakti se i njëjti me datë 17.03.2023 ka mbaruar studimet themelore në Kolegjin UBT-Programi Juridik dhe po ashtu posedon Vërtetimin e datës 06.05.2025 të lëshuar nga Handikos që dëshmon gjendjen shëndetësore, kurse lidhur me përvojën e punës i njëjti posedon Kontratën e punës praktike të lëshuar nga Koci & Vokshi Sh.P.K, përmes të cilës dëshmohet se i njëjti ka kryer punën praktikën në kohëzgjatje (1 vit) nga data 29.06.2023, nga rrjedh se i njëjti i ka plotësuar kushtet e veçanta dhe kriteret e përgjithshme formale të përcaktuara si në konkursin e datës 29.04.2025, ashtu që në konkursin e datës 29.04.2025 për pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Gjilan, procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtueshmëri parimet e përgjithshme të pranimit sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, prandaj lidhur me këtë rast pretendimi ankimor i ankuesit refuzohet ndërsa mbetet në fuqi Formulari i vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, të datës 02.07.2025 për pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Gjilan, sikurse në dispozitiv e këtij vendimi.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi si dhe duke marr për bazë kuadrin ligjor në fuqi, dispozitat e LPPA-së dhe të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit

dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, vendosi që ankesën e ankuesit të datës 01.08.2025 ta aprovoi pjesërisht si të bazuar, ashtu që u aprovua pretendimi ankimor se procedura e rekrutimit për pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Ferizaj, nuk është zhvilluar në pajtim me nenin 3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, pasi që kandidati i suksesshëm rezultoi që nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit, ndërsa u refuzuan pretendimet ankimore të ankuesit se procedurat e rekrutimit për pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Gjiilan dhe Prishtinë janë zhvilluar në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, pasi që Kolegji i Këshillit konstatoi se procedura e rekrutimit ishte shpallur në pajtueshmëri me Rregulloren Nr. 02/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor dhe se kandidatët e suksesshëm në këto dy raste i kishin plotësuar kriteret e përcaktuara të konkursit dhe për rrjedhojë ishte zbatuar drejt neni 3 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, ndërsa mbeten në fuqi Formularët e vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, të datës 02.07.2025 për pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Gjiilan dhe Prishtinë, ashtu që Njësia e Burimeve Njerëzore obligohet të veproi në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 26 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Andaj, pas konstatimeve të dhëna si më lart dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë Juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendim.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1520/2025, datë 30/09/2025.

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, G.H;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njesisë të Burimeve Njerëzore);
- Arkivit të KPMSHCK-së.